



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Drejtoria e Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Rektoratin e Universitetit “Aleksander Xhuvani” shpall konkurs për pozicionin e punës **1 (një)** specialist komunikimi me kohë të plotë.

Specialist i komunikimit: përgjigjet për ndjekjen dhe komunikimin institucional jo vetëm brenda Universitetit të Elbasanit por edhe me institucionet e tjera duke bashkëpunuar me strukturat jo vetëm brenda drejtorisë, por edhe më gjërë; është përgjegjës për propagandimin, marrjen e përgatitjen e informacionit organeve të shtypit apo formave të komunikimit zyrtar institucional; përgatit konferencat e shtypit; ndihmon në zbatimin e protokollit zyrtar institucional. Kryen me përpikmëri e nivel të lartë profesional të gjitha detyrat që ngarkohen. Raporton në kohë dhe cilësi tek drejtori i drejtorisë.

Kriteret e përgjithshme:

- Të ketë mbaruar studimet universitare të ciklit të dytë (Master) ose diplomë ekuivalente me të në fushën e shkencave humane. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura dhe njehsuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.
- Të ketë njohuri të paktën e një gjuhe të huaj të vërtetuar me dokumentacion.
- Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- Ndaj tij të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të ketë përvojë të mëparshme pune.
- Të jetë i aftë për punë.

Kriteret e veçanta:

- Të ketë përvojë të mëparshme në fushën e komunikimit dhe shkrimeve.
- Të ketë trajnime dhe kualifikime në fushën e komunikimit.
- Të jetë njohës i mirë i përdorimit programeve kompjuterike.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore Protokoll Arkiv të Rektoratit të Universitetit të Elbasanit “Aleksander Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) **18.10.2021 – 27.10.2021** ditëve dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Letër motivimi për pozicionin e punës *specialist komunikimi* në Drejtorinë e Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë
- Jetëshkrimin e tij/saj;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

- Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës;
- Çertifikata, kualifikime, dëshmi, rekomandime për aftësi të ndryshme, të njehsuara me origjinalin;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;
- Raport i gjendjes shëndetsore, që vërteton aftësinë për punë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Fotokopje e letërnjoftimit.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve **18.10.2021 – 27.10.2021** nga në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim për pozicionin e punës: *specialist komunikimi*
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e **Rektoratit**. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do të nënshtohen intervistës me gojë (28.10.2021 – 10.11.2021). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.